

NJOFTIM PËR SHTYP

Në institucionin e Avokatit të Popullit në datën 12/12/2023 u zhvillua mbledhja e Komisionit Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga radhët e shoqërisë civile.

Pjesëmarrësit në mbledhje ishin, z. Gentjan Sejrani Kryetar, z. Rigels Xhemollari sekretar, z. Eduart Mazi, anëtar, znj. Ada Ilia, anëtare dhe z. Arbër Ademi, anëtar.

Të pranishëm në mbledhjet, me statusin e vëzhguesit ishin gjithashtu përfaqësuesit nga misioni OPDAT në Shqipëri, EU4Justice, OSCE dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Në këtë mbledhje u zhvilluan seancat dëgjimore me katër kandidatët që plotësonin kriteret formale ligjore, për të vlerësuar kriteret profesionale morale, bazuar në rregulloren e komisionit.

Pas zhvillimit të seancave dëgjimore, Komisioni i Shoqërisë Civile, vlerësoi me pikë kandidatët e kualifikuar dhe shpalli rankimin si më poshtë:

Kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor nga radhët e shoqërisë civile rankohen si më poshtë:

Vendi i parë: Erion Fejzulla
Vendi i dytë: Altin Hazizaj
Vendi i tretë: Juelda Lamce
Vendi i katërt: Violanda Theodhori.

Kandidatët për Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga radhët e shoqërisë civile rankohen si më poshtë:

Vendi i parë: Erion Fejzulla
Vendi i dytë: Altin Hazizaj
Vendi i tretë: Juelda Lamce







